




qendra e provimeve


SHIFRA  
E NXËNËSIT



PROVIMI I MATURËS DHE PROVIMI PROFESIONAL

**GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**

QERSHOR, 2023



\* A 1 2 3 0 0 0 2 \*



**KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA**

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike.

Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Testi DUHET të shkruhet LEXUESHËM me laps kimik. Nxënësi/nxënësja mund të shkruaj me shkronja dore ose shtypi. Nëse shkruan me shkronja shtypi DUHET të theksojë shkronjën e madhe.

Testi përmban detyra të cilat zgjidhen në një rën prej mënyrave në vazhdim:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar një tekst funksional
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes të përshkruash përgjigjet tua.

**Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:**

- është e pasaktë
- përgjigja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë NUK është bart në fletën e përgjigjeve
- është rrethuar ose shkruar edhe përgjigja e saktë dhe e pasaktë
- përgjigja/eseja është e palexueshme dhe e paqartë
- përgjigja/teksti funksional/eseja është shkruar me laps të thjeshtë
- teksti funksional/eseja NUK është shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në faqet e parapara për koncept (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Nëse gabon, vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri.

Kur ta përfundosh punën, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tua.

**Me fat!**



## Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

### Fobitë e njerëzve dhe klasifikimi i tyre

Rreth 15 për qind të njerëzve, sipas disa sondazheve, vuajnë nga një fobi të paktën një herë në jetë. Motori kërkues “Yahoo!”, ka publikuar një listë të fobive më të kërkuara nga përdoruesit gjatë muajve të fundit. Ja cilat janë fobitë për të cilat kërkohet më shumë informacion, nga të cilat njerëzit vuajnë më shumë: Agorafobia është frika nga hapësirat publike. Ata që vuajnë nga kjo fobi ndihen keq kur gjenden në vende të hapura, sepse i druhen faktit se nuk do të mund të kontrollojnë situatën në të cilën mund të gjenden. Sigurisht që kjo kategori njerëzish preferon të qëndrojnë në shtëpi. Agorafobikët nuk kanë frikë vetëm nga hapësirat publike, por edhe në vende si dyqane apo mjetet e transportit publik.

Tripofobia është njëra ndër fobitë më të reja dhe paraqet frikën nga vrimat. Ky term është shpikur gjatë viteve të fundit dhe ka të bëjë me frikën nga objektet me vrima të vogla dhe të ngushta, siç janë kosheret e bletëve.

Ksenofobinë e kanë njerëzit që kanë frikë prej atyre që janë ndryshe nga vetvetja. Njerëzit janë ndryshe nga njëri-tjetri nga feja, kombësia, ngjyra etj. dhe kjo është shpesh shkak për diskriminim. Kjo është një lloj fobie shumë e përhapur, të cilën e shfrytëzojnë shumë lëvizje politike për të fituar besimin e elektoratit.

Araknofobinë e kanë njerëzit që kanë frikë nga merimangat. Kjo mund të manifestohet që nga neveria deri te paniku. Kush vuan nga kjo fobi nuk ka frikë vetëm nga merimangat e gjalla, por reagon edhe kur sheh foto të tyre.

Fobia më e përhapur te fëmijët është koulrofobia dhe do të thotë se ata kanë frikë nga kllounët. Frika nga kllounët haset edhe tek adoleshentët dhe te të rriturit, por më rrallë. Njerëzit që tremben nga lartësitë e kanë fobinë të quajtur akrofobia. Të pafuqishëm ndihen njerëzit që vuajnë nga sëmundje të lukthit, të cilat shkaktojnë vjellje, sepse ata nuk mund ta përmbajnë të vjellët. Kjo fobi ose emetofobia mund të shkaktojë pasoja të rënda shëndetësore. Nëse vëreni ndonjë njeri që djersitet nga vendet e mbyllura dhe të ngushta, nuk do të thotë se ka nxehtë, por ai ka frikë nga vendet e atilla. Kjo fobi quhet klaustrofobi dhe është një nga fobitë më të shpeshta.

Hidrofobinë e kanë njerëzit që kanë frikë nga uji. Ka dhe fobi të tjera të ngjashme. Ajo që manifestohet me frikë për t'u futur në ujë quhet akuafobi, kurse frika nga deti quhet thalasofofi. Niktofobia është frika nga errësira, që mund të shkaktojë edhe panik. Në klasifikimin e Yahoo-së renditet e fundit, megjithatë është një ndër fobitë më të përhapura.

*(d.b/atsh/Balkan web)*

**1. Sa është përqindja e njerëzve që vuajnë nga më së paku një frikë?**

---

1 pikë

**2. Tripofobia ka të bëjë me frikën nga:**

1. vendet e hapura
2. objektet me vrima
3. vendet e mbyllura

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

1 pikë

**3. Cilat janë parapëlqimet e njerëzve që kanë frikë nga hapësirat publike?**

---

1 pikë

**4. Çfarë i karakterizon ksenofobët?**

---

1 pikë

**5. Nga çka kanë frikë araknofobët dhe si shfaqet ajo?**

---

---

2 pikë

**6. Çka është emetofobia?**

---

1 pikë

## Duke shfrytëzuar tekstin, zhvillo detyrat 7, 8, 9 dhe 10.

Kur e vunë kufomën në karrocën e të vdekurve, erdhën dy karroca me emblema, po bosh, ajo e kontit Dë Resto dhe ajo e baronit Dë Nysingen, dhe e përcollën të vdekurin gjer në varrezat Perë-Lashezë. Më ora gjashtë, trupi i xha Goriot u zbrit në varr, rrotull ish in karrocierët e të bijave, po dhe ata u zhdukën menjëherë bashkë me priftërinjtë, me të mbaruar lutja e shkurtër që u këndua për babëlokun me të hollat e studentit. Si hodhën ca lopata dhe mbi tabutin për ta mbuluar, të dy varrmihësit u ngritën dhe njëri syresh i kërkoi Rastinjakut bakshishin. Eugjeni futi dorën në xhep, po s'gjeti asnjë dhjetësh; u shtrëngua t'i merrte hua Kristofit njëzet solda. Ky rast që në vetvete s'kishte asnjë rëndësi, e mbushi Rastinjakun me një trishtim të thellë. Kishte zënë të ngrysej, një muzg i lagësht të cingëriste nervat; ai vështroi varrin dhe mbuloi në të lotin e fundit të djalërisë, atë lot të shkëputur nga emocionet e shenjta të një zemre të kulluar, një nga ata lot që, nga toka ku bien, çohen gjer në kupë të qiellit. Kryqëzoi duart dhe soditi retë; tek e pa kështu, Kristofi iku dhe e la.

Rastinjaku mbeti vetëm; bëri disa hapa në të përpjetën e varrezave dhe pa Parisin, që gjarpëronte nga të dyja anët e lumit Senë, ku zunë të llamburisnin dritat. Sytë e tij u mbërthyen me lakmi në mes të shtyllës së sheshit Vandomë dhe kubesë së Shtëpisë së Invalidëve, atje ku jetonte ajo shoqëri e lartë e Parisit, objekti i synimeve të tij. Eugjeni i hodhi asaj koshereje që zुकaste një vështrim, si t'i thithte që më parë mjaltin, e tha këto fjalë:

- Tani të shohim se kush do të fitojë; unë apo ti:  
dhe, duke i hedhur sfidën kësaj shoqërie, ai shkoi për drekë te zonja Dë Nysingen.

*Sashë, shtator 1834*

*„Xha Gorio” Honore dë Balzak*

### 7. Paragrafi i parë i fragmentit të dhënë është:

1. monolog
2. dialog
3. përshkrim

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

*1 pikë*

### 8. Cila është tema e këtij fragmenti?

*1 pikë*

**9. Rretho numrin para ndjenjës mbizotëruese që e kaplon Rastinjakun dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.**

1. boshllëku
2. gëzimi
3. nostalgjia
4. pikëllimi

1 pikë

**10. Në cilin drejtim letrar bën pjesë vepra nga e cila është shkëputur kjo pjesë?**

---

1 pikë

**11. Radhiti veprat në vazhdim sipas kronologjisë së paraqitjes së tyre në letërsi.**

*Andrra e jetës*

*Hamleti*

*Duke pritur Godonë*

*Këngët e Milosaut*

*Eugjen Onjegin*

---

---

1 pikë

**Lexo fragmentin nga *BAGËTI E BUJQËSIA* e Naim Frashërit dhe zhvillo detyrat 12, 13 dhe 14.**

O malet e Shqipërisë! E ju o lisat e gjatë,  
Fushat e gjera me lule, q'u kam nër mënt dit' e natë  
Do të këndojs bagëtinë, që mbani ju e ushqeni,  
Ti Shqipëri, më ep nderë, më ep emërin Shqipëtar"  
Zemërën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.  
Shqipëri! O mëma ime! Ndonëse jam i mërguar,  
Dashurinë tënde kurrë, zemëra s'e ka harruar.  
Kur dëgjon zëthin e s'ëmës qysh e le qengji kopenë  
Blegërinë dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë;  
Ku i fryn bariu xhurasë, tek kullosin bagëtia,  
Ku mërzen cjapi me zile, atje i kam mënt' e mija  
Atje lint diell'i qeshur edhe hëna e gëzuar,  
Mendja! merr fushat e malet, jashtë, jashtë nga qyteti

Nga brega, nga thashethemat, nga rrëmuja, nga rrëmeti-  
Vashë bukurosh' e bariut që vjen me llërë përveshur,  
Me zemërë të dëfryer e me buzëzë të qeshur,  
Me dy shqerazë ndër duar të bukura, si dhe vetë.

**12.** Kush janë personazhet qendror lirik në këtë poemë që shkrihen natyrshëm me unin poetik?

---

*1 pikë*

**13.** Cilën figurë përdor autori në vargun e parë dhe cilën në vargun e tetë dhe të nëntë?

---

---

*2 pikë*

**14. A)** Rretho numrin para trajtës së ligjërimit që ka përdorur autori në këtë fragment.

1. dialogun
2. vetërrëfimin

*1 pikë*

**B)** Argumentoje përgjigjen nën A duke treguar frymën që e përshkon fragmentin dhe rishkruaji vargjet ku përdoret trajta e ligjërimit që ke rrethuar.

---

---

---

---

*2 pikë*



**15. Vetëm njëra nga vetitë e dhëna ka të bëjë me karakterin e Hamletit tek vepra me të njëjtin titull e Uilliam Shekspirit, veçoje atë dhe argumentoje përgjigjen.**

është simbol i durimit

është simbol i humanizmit

është *makinë* e krimin

---

---

2 pikë

**16. Lexoje paragrafin nga vepra *Evgjeni Grande* (Honore de Balzak) dhe zhvillo detyrën.**

Prifti doli. Zonjusha Grande u ngjit në dhomën e vet dhe qëndroi tërë ditën vetëm, pa zbritur as për të ngrënë darkë, me gjithë lutjet e Nanosë. Në mbrëmje, kur erdhën mysafirët, ajo zbriti dhe e gjeti sallonin plot; kurrë ndonjëherë s' patën ardhur aq shumë. Lajmi i kthimit të Karlit dhe marrëzia e tradhtisë së tij, ishin përhapur në tërë qytetin. Po me gjithë kureshtjen që kishin vizitorët, Evgjenia mbajti një gjakftohtësi shembullore dhe asnjë nga brengat e brendshme, nuk u shfaq në fytyrë. Ajo u përgjigjej me buzëqeshje atyre që tregonin interes për të ose përdornin ndonjë shprehje melankolike. Nën vellon e mirësjelljes, ajo mundi ta fshehë fatkeqësinë e vet.

**A) Gjeje ndonjë detaj që tregon mënyrën se si Evgjenia e zotëron plotësisht veten.**

---

1 pikë

**B) Argumento përgjigjen nën A duke shpjeguar përmes atyre detajeve ndryshimin që ka pësuar ajo.**

---

---

1 pikë

**17. Cikli i kreshnikëve merr formën e këngëve legjendare nga:**

1. kontradiktat midis grupeve shoqërore
2. përfshirja e qenieve përrallore
3. prania e elementeve të kuvendimit
4. prania e natyrës së rrëmbyer

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

1 pikë

**18. Lexoje paragrafin në vazhdim pastaj përgjigju në pyetjen nën A dhe B.**

Në natyrën e poezisë së këtij autori, është komunikimi poetik; komunikimi me imazhe, me fjalë e me gjeste, që përmbajnë ngarkesë poetike. Madje kjo përbën esencën e komunikimit njerëzor. Manifestimi dhe komunikimi i këtillë poetik, është pjesë e një konteksti, gjithnjë duke nënkuptuar statusin e imagjinares.

**A) Cilës fushë të shkrimit i takon paragrafi i mësipërm?**

---

1 pikë

**B) Në cilin ligjërim bëjnë pjesë togëfjalshat e përdorur, si: komunikimi poetik; komunikimi me imazhe e fjalë, etj.?**

---

1 pikë

**19. Cili është antonimi i fjalës (emër) rini?**

---

1 pikë

**20. Ktheje foljen e diatezës pësore në veprorë.**

Këmbët e tij të shumta, fije të holla mjerane në krahasim me pjesën tjetër masive të trupit, valëviteshin pa kuptim para syve të tij.

---

---

1 pikë

**21. Gjej shprehjet përkatëse të cilat i zëvendësojnë fjalët e mëposhtme.**

1. Toleroj – \_\_\_\_\_
2. Inkurajoj – \_\_\_\_\_
3. Inskenoj – \_\_\_\_\_

1 pikë

**22. A) Rretho numrin para fjalës së shkruar gabim.**

1. çkatërroj
2. zhbart
3. zhvesh

1 pikë

**B) Argumento përgjigjen.**

---

---

1 pikë

**23. Zgjeroje fjalinë “Buzëqeshi e mrekulluar.” me një pjesë të nënrenditur rrethore (kohore, mënyrore).**

Kohore \_\_\_\_\_

Mënyrore \_\_\_\_\_

2 pikë

**24.** Shkruaj një letër personale shokut ose shoqes me të cilin apo me të cilën, këtë vit për shkaqe objektive, nuk do të mund të ndani çastet e shoqërimit tuaj me rastin e përfundimit të shkollës së mesme.

Respekto formën e letrës personale: të adresuarin, përshëndetjen hyrëse, objektin e letrës, përshëndetjen përmbyllëse, emrin dhe nënshkrimin e dërguesit si dhe vendin e datën e shkrimit të saj. Ki kujdes përdorimin e drejtë të gjuhës standarde.

*8 pikë*











**25.** Janë dhënë dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë.

- Me rastin e zhvillimit të temës, shfrytëzo shembujt relevant/të dhënat dhe argumento qëndrimet personale.
- **Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10%**  
(vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHE FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi). Eseja DUHET të shkruhet në fletët e parapara për shkrimin e esesë (eseja e shkruar në fletët e konceptit NUK LEXOHE).
- Bëj kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.

### **1. Çajld Haroldi – XH.G.Bajron**

#### **UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:**

- Shkruaj për përmbajtjen e veprës Çajld Haroldi?
- Trego për pikëpamjet estetike të veprës, motivet e konfliktit. Në çfarë dallohen ato?
- Shkruaj për veçoritë e Çajld Haroldit.

### **2. Mos i ndërprit të tjerët kur flasin dhe mos i përfundo ti fjalitë e tyre**

#### **UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:**

- Trego për sjelljen tënde që ke në raport me ndërprerjen e të tjerëve kur flasin ata dhe përfundimit të fjalëve të tyre.
- Shkruaj për dëmet, pasojat e këtij vesi ndaj respektit dhe dashurisë që merr nga të tjerët dhe energjinë që harxhohet duke u përpjekur të jesh brenda mendjes së dy personave njëherësh. Për reagimin e të tjerëve ndaj një sjelljeje të tillë.
- Shkruaj për dëshirën që ke të ndryshosh veten apo të tjerët, nëse e kanë një prirje të tillë që është një zakon i bezdisshëm e që mund të bëhet edhe refleksi i keq. Për ndjenjat tua dhe të tjerëve nëse e ke bërë apo e kanë bërë këtë.

*13 pikë*













